



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 12.09.2024

Nr: 177

Ora: 10:30

VENDIM

PËR

DHËNIEN E MANDATIT TË KRYETARIT TË BASHKISË HIMARË, QARKU VORË Z. VANGJEL LLAMBI TAVO, PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË HIMARË TË DATËS 4 GUSHT 2024

Sot më datë 12.09.2024, mora në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Dhënie e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë, z. Vangjel Llambi Tavo, propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për zgjedhjet e pjesshme të datës 4 Gusht 2024.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, neni 33, shkronja “g” dhe neni 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

VËREJ:

Në mbështetje të Dekretit nr. 244, datë 05.07.2024, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zhvillimit të zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë”, u zhvilluan zgjedhjet e pjesshme të datës 4 Gusht 2024.

Bazuar në nenin 33, shkronja “g”, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 88, Bashkia Himarë, Qarku Vlorë me vendimin nr. 85, datë 05.08.2024 vendosi miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Himarë, në zgjedhjet e pjesshme të datës 04.08.2024 dhe të shpallë fitues z. Vangjel Llambi Tavo, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

Data: 12.09.2024 Nr: 177
Ora: 10:30



“Për dhënie e mandatit të kryetarit të bashkisë Himarë, qarku Vlorë z. Vangjel Llambi Tavo, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 Gusht 2024”.

Në datë 09.08.2024 është depozituar në KAS kërkesa ankimore me nr. 11 nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, me objekt:

1. *Kundërshtimin e vendimit nr. 85, datë 05.08.2024 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Himarë në zgjedhjet e pjesshme të datës 04.08.2024”, të KZAZ nr. 88;*
2. *Pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në të gjitha QV (gjithësej 36 QV-të) të zonës zgjedhore, bashkia Himarë;*
3. *Rregullimin e pasojave duke shpallur pavlefshmërinë e zgjedhjeve për bashkinë Himarë.*

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, pasi shqyrtoi çështjen, me vendimin nr. 19, datë 26.08.2024 vendosi rrëzimin e kërkesës ankimore dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 85, datë 05.08.2024 të KZAZ nr. 88.

Në datë 03.09.2024 pranë Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor janë depozituar 2 (dy) kërkesë padi, nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë” dhe “Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut”, ndaj vendimit nr. 19, datë 26.08.2024 të KAS.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor me vendimin nr. 05, datë 09.09.2024 vendosi unanimisht, rrëzimin e padisë së palës paditëse Koalicioni “Bashkë Fitojmë” dhe “Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut”.

Bazuar në nenin 166, pika 1, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, Kryetar Bashkie zgjidhet kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që kanë votuar në njësinë vendore përkatëse.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, neni 33, shkronja “g” dhe nenin 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSA:

1. Dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë, z. Vangjel Llambi Tavo, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Illirjan CELIBASHI